



05Nr 1881 /2022

15.03.2022

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Kapitulli V neni 67 dhe 68 ,Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8,Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032 neni 35, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm neni 8 pika 6, Udhëzimin Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik,**Drejtoria Komunale e Arsimit** shpallë:

K O N K U R S

PËR ASISTENT PËR FËMIJË/NXËNËS ME NEVOJA TË VEÇANTA

Titulli i vendit të punës: **Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta**

Institucioni: **Komuna Hani Elezit**

Drejtoria: **Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**

Lloji i pozitës: **Shërbimit Publik**

Numri i pozitave: **Dy (2) pozita**

Orari i punës : **40 orë në javë**

Titulli i mbikqyrësit: **Drejtori i shkollës**

Koeficienti/Grada: **Paga bazë 397.01€**

Kohëzgjatja: **Me kohë të caktuar**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndhmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë;
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndët të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgadit materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashte klasës;
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuara të fëmijëve, përgadit informatat kthyesë për vështirësit dhe arritjet e fëmijëve.
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijet në komunikim, pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës;

- Mbykqyre dhe ndihmon fëmijët dhe nxënësit gjatë racioneve ushqimore kujdest për nevojat e tyre fizike/ personale, mjekësore dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë përgjithshme të tyre;
- Planifikon me mësuesin/mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim.
- Promovon bashkëpunimin shkolle - shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve;
- Informacionet në shkolle i trajtojnë si plotësisht konfidenciale;

Kualifikimi dhe kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

- **Niveli 5-të(post sekondar) i kualifikimit asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore.**

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jene kopje të vërtetuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT-i, tjerat jo profesionale nuk shqyrtohen.
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 14.04.2022 deri 28.04.2022 (16:00).

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net> Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të

njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirëpritën aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> , në webfaqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezit> dhe në tabelën e shpalljes.



Drejtori për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Hisni Luri